



# Udhëzime për trajtimin e fëmijëve me simptoma ftohjeje në qendrat e kujdesit ditor të fëmijëve

S. 25-28

Fletë informuese për prindërit dhe kujdestarët

Gültig ab 01.9.2020

## Fletë informuese për prindërit dhe kujdestarët

Të dashur prindër, të dashur kujdestarë,

me anë të kësaj flete informuese do të merrni udhëzime dhe rekomandime për zbatimin e udhëzimeve për trajtimin e fëmijëve me simptoma ftohjeje. Masat që duhen marrë janë hartuar në bashkëpunim me autoritetet rajonale për sigurinë e ushqimit dhe shëndetin në Bajern, si dhe me mjekët pediatër të fëmijëve dhe të adoleshentëve, me specialistë të mjekësisë së përgjithshme në këshillim me Ministrinë Shtetërore për Shëndetin dhe Kujdesin dhe me Ministrinë Shtetërore për Familjen, Punën dhe Çështjet Sociale në Bajern.

Qëllimi është mundësimi i funksionimit të rregullt të qendrave të kujdesit ditor të fëmijëve dhe parandalimi i përhapjes së SARS-CoV-2 me anë të masave parandaluese. Për këtë është e nevojshme të bëhet dallimi midis infeksioneve të rrugëve të frymëmarrjes të shkaktuara nga viruse të zakonshëm dhe infeksioneve të shkaktuara nga SARS-CoV-2.

### **Mbrojtja më e mirë është mbajtja e një niveli të ulët infeksionesh në rajon.**

Çdo individ mund të japë një kontribut të madh në shoqëri për këtë. Edhe ju si prindër apo kujdestarë. Të gjithë së bashku mbajmë përgjegjësinë për t'i garantuar fëmijëve vajtjen në qendrat e tyre ditore pa ndërprerje të gjata, në të mirë të shëndetit të fëmijëve dhe të familjeve.

#### **A) Cilat janë detyrat tuaja si prindër ose si kujdestarë?**

- Të kontribuoni për raste sa më të ulëta infeksioni në rajon, duke respektuar rregullat e higjienës. Të shmangni grumbullimet masive dhe të ruani distancën e nevojshme minimale.
- Të përdorni aplikacionin Corona.
- Të mos e çoni fëmijën tuaj në qendrën e kujdesit, nëse
  - është sëmurë dhe ka këto shenja të sëmundjes: temperaturë 38 e lart, diarre, dhimbje të forta stomaku, kollë ose
  - nëse ju apo fëmija juaj keni pasur kontakt me një person pozitiv me SARS-CoV-2,
  - nëse ju si i rritur keni simptomat e CoVID-19 (kollë, temperaturë, humbje të shijes)
- Përgjegjësit e qendrës ditore kontrollojnë në bazë të disa kriterëve të caktuara, nëse ekziston ndonjë rrezik dhe si rrjedhojë një arsye për mospranimin në qendër.
- Duke firmosur një formular të dhënë nga qendra, konfirmoni se i njihni udhëzimet e mëposhtme dhe se fëmija juaj mund të hyjë në qendër pa rrezikuar veten dhe të tjerët.

#### **B) Cilat janë detyrat e përgjegjësve të kujdesit ditor të fëmijëve?**

- Përgjegjësit e qendrës ditore të kujdesit të fëmijëve kanë për detyrë të kontrollojnë se kush mund të hyjë në qendër. Kjo është e nevojshme për të garantuar që në qendër të hyjnë vetëm fëmijë të shëndetshëm, duke reduktuar kështu rrezikun e përhapjes. Kjo masë shërben njëkohësisht për të garantuar funksionimin e rregullt për të gjithë.
- Nëse nuk lejohet hyrja, prindërit do të marrin formularin e plotësuar "Përrjashtim nga kujdesi në qendrën komunitare". Atyre do t'u rekomandohet të kontaktojnë me mjekun e tyre pediatër ose me mjekun e familjes.

### **C) Cilat janë detyrat e mjekut?**

- Mjeku bën një vlerësim individual të rrezikut dhe vendos nëse fëmija duhet të dërgohet në ambulancë në bazë të simptomave dhe të këshillave të tij.
- Mjeku merr vendimin nëse duhet të bëhet një tampon apo test për infektimin me SARS-CoV-2.
- Mjeku merr vendime të tjera në lidhje me nevojën e një trajtimi simptomatik.
- Nëse nevojitet, mjeku lëshon një certifikatë për ta paraqitur pranë qendrës ditore.
- Kjo bëhet me pagesë. Kostot janë në ngarkim të prindërve/kujdestarëve.

## Pyetje të shpeshta për prindërit

### **1. Fëmija im kollitet dhe teshtin. Cilat simptoma janë “normale” dhe cilat simptoma nënkuptojnë SARS CoV-2?**

Nuk ka një përgjigje të saktë për këtë. Duhet të kontaktoni gjithmonë mjekun pediatër ose mjekun e familjes, nëse fëmija juaj shfaq një gjendje jo të zakonshme, e cila zgjat p.sh. më shumë se dy ditë. Konkretisht, kjo do të thotë:

- A ka temperaturë fëmija juaj? Apo një temperaturë të lartë trupore 38 e lart?
- A ka fëmija juaj simptoma të tilla si kollë, dhimbje fyti ose veshësh?
- A ka fëmija juaj dhimbje stomaku, të vjella, diarre ose acarim të lëkurës pa shkak të njohur?
- Nëse nuk keni arritur t'i lehtësoni simptomat përmes masave të zakonshme dhe nuk ka përmirësim të gjendjes së përgjithshme, atëherë duhet t'i drejtoheni një mjeku.

### **2. Nuk do të ishte më mirë të shkoja menjëherë në ambulancë?**

Jo, është më mirë nëse kontaktoni me ambulancën përmes telefonit. Personeli do të bisedojë me ju lidhur me procedurën në vijim. Disa kërkesa mund të sqarohen më mirë përmes telefonit, për të shmangur kohë të gjata të panevojshme pritjeje në ambulancë.

### **3. Kur duhet të shqetësohem se fëmija im mund të jetë sëmurur me SARS CoV-2?**

Një person joprofesionist nuk mund të vendosë nëse simptomat janë të sëmundjes Covid-19 apo të infeksioneve nga viruse të tjerë. Për këtë është e rëndësishme të ngrini pyetjet e mëposhtme:

- A kam arsye të shqetësohem që mund të bëhet fjalë për një infektim me SARS-CoV-2 ? Bëjini vetes pyetjet e mëposhtme:
  - A po rriten numrat e infektiveve me SARS-CoV-2 në fshatin/qytetin/qarkun tim?
  - A kam qenë gjatë ditëve të fundit në një rajon me rrezikshmëri?
  - A kam qenë në kontakt me një person të sëmurë me SARS-CoV-2?

Nëse i jeni përgjigjur me “po” të gjitha këtyre pyetjeve, duhet të kontaktoni me një mjek pediatër ose me mjekun e familjes. Ju lutemi të telefononi paraprakisht, për të vlerësuar nëse është e nevojshme të paraqiteni personalisht.

### **4. Kur do të ishte e arsyeshme, sipas këndvështrimit mjekësor, që fëmija im të bëjë testin e SARS-CoV-2?**

Vendimi nëse testi është i këshillueshëm merret nga mjeku pediatër, mjeku i familjes ose autoritetet shëndetësore.

### **5. Nëse fëmija im do të kishte shenja të sëmundjes në mëngjes, si kollë, rrufë dhe shumë pak temperaturë. Mua do të më duhet të shkoja në punë dhe nuk do të kisha se kush të kujdeset për fëmijën tim.**

**A duhet ta çoj fëmijën në qendrën ditore, pasi nuk duket të jetë “vërtet i sëmurë”?**

Jo, në kuadër të përgjegjësisë së përgjithshme kundrejt shoqërisë dhe për sa i përket aspektit shëndetësor, duhet të veproni në mënyrë të përgjegjshme. Mos i vini edukatorët në pozitën e vështirë për të vendosur nëse fëmija duhet të merret mbrapsht. Në këtë mënyrë nuk ndihmoni as veten, as fëmijën.

Qendrat ditore mund të vazhdojnë të qëndrojnë hapur, vetëm nëse edhe prindërit ndihmojnë duke marrë përsipër përgjegjësitë e tyre. Fëmija juaj do të jetë sërisht në formë të mirë pas dy ose tre ditësh, kështu edhe qendra ditore do të mund të qëndrojnë e hapur.

**6. A duhet të bëjnë përjashtime përgjegjësit e kujdesit ditor të fëmijëve, për shkak të ndonjë problemi individual në raste të veçanta?**

Jo. Përgjegjësit duhet të respektojnë udhëzimet e ministrive. Është e kuptueshme që ka edhe situata të vështira. Por shmangni çdo lloj diskutimi me përgjegjësit e qendrës ditore, pasi ata janë të detyruar të respektojnë udhëzimet. Vetëm përmes një mirëkuptimi të ndërsjellë mund të parandalojmë përpapjen e si rrjedhojë edhe mbylljen e qendrave ditore të kujdesit të fëmijëve.

**7. Kur do të ishte i mundur kthimi në qendrën ditore të kujdesit të fëmijëve?**

Kur gjendja e përgjithshme e fëmijës të jetë e mirë dhe të paktën 48 orë pas zhdukjes së simptomave dhe rënies së temperaturës. Pranimi sërisht në qendër është i mundur pa certifikatë mjekësore.